



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Data	18.10.2022	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
	01	104/02-28137	-1.

Procesverbal nga Dëgjimi publik: Lidhur me Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe planifikimet për vitet 2024-2025 me sektorin e shëndetësisë

Debat me sektorin e shëndetësisë në Komunën e Kaçanikut

Vendi : QKMF

05.08.2022

Ora : 14:00

Fillimisht takimin e hapi drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Sali Malsiu. Drejtori tha se investimet komunale në shëndetësi do të jenë prioritet edhe për vitet vijuese sa i përket investimeve komunale, ndërsa kërkoi nga të pranishmit në debat që të japin kontributin e tyre në kërkesat dhe problemet me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë në institucionet shëndetësore.

Komentet:

Ekrem Dullovi Zëvendës drejtor në QKMF-

Jam i interesuar të informohem më shumë në lidhje me projektin në ndërtimin e Ambulantës së re në Doganaj, në çfarë faze janë punimet?
Me inventar dhe pajisje për shërbime jemi mjaft të kënaqur me komunën, ndërsa dua të di se si do të veprohet në disa raste kur disa fshatra janë duke u zbrazur e disa të tjera të mbipopulluara.

Sinan Zeneli- Drejtor në QKMF

Më herët është menduar më politikisht për shëndetësinë në përgjithësi, un nuk jam pro mbylljes së AMF-ve dhe QMF-ve por duhet të bëhet një riorganizim më i mirë, më pas duhet të analizohet situata që edhe për pasojat që mund ti kemi, sepse nëse ka pak pacientë atëherë edhe stafi mjekësor bëhet pasiv në profesionin e vet. Pra të bëhet një studim më i gjerë që më pas të bëhet një zgjidhje e mirë. Kërkojmë dezinfektim të hapësirave publike, me pajisje jemi mirë, investime kapitale kemi bërë mjaftueshëm, kemi objektin QKMF-së në qendër të qytetit që është shembulli më i mirë pothuajse në tërë Kosovën. Ndërsa një problem tjetër i theksuar është mungesa e mbajtjes së kujdestarisë nga barnatoret gjatë orarit të natës.

Filkizare Dema- Kryeinfermiere

Kemi mungesë dhe kuadro të stafit mjekësor, psh ka mjete të aparaturës për laborator por ka mungesë të laborantëve, përndryshe falënderoj Kryetarin dhe të gjithë sektorët komunal siç është edhe prokurimi që na ka ndihmuar në zbatimin e buxhetit pa pengesa.

Arben Koxha- Laborant

Pajisje për laborator kemi po ende nuk janë vendosur për të hyrë në funksion në qendra mjekësore, por duhet sa më shpejtë sepse mjetet e reja po avancojnë çdo ditë e më shumë.

Lulzim Hoxha- Specialist i Mjekësisë Familjare

Ikja e mjekëve problematike, mungesë të mjekëve familjarë, e specialistë të tjerë për shërbime specialistike. Poashtu kërkojmë blerjen e një veture për nevojat administrative të QKMF-së.

Të pranishmit në debat morën përgjigje dhe bashkëbiseduan me ekzekutivin komunal, ndërsa përgjigjet zyrtare janë të paraqitura edhe në raportin e konsultimit publik me po të njetën temë.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

I	Data	18.10.2022	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-28137-2			

Procesverbal nga Dëgjimi publik: Lidhur me Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe planifikimet për vitet 2024-2025 me banorët e lokaliteteve Dubravë, Nikaj, Rekë, Soponicë etj

Data: 17.08.2022

Vendi: Shkolla Fillore "Kadri Zeka" Dubravë

Ora: 18:00

Takimin e hapi nënkryetari i Komunës së Kaçanikut Sabedin vishi, i cili foli edhe për buxhetin komunal si dhe për rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në dëgjimet publike.

Ai tha se buxheti për vitin 2023 ka arritur shifrën 10 milionëshe, ndërsa vetëm për kategorinë investimet kapitale janë të planifikuara 2 milion e 971 mijë e 313 euro. Sipas tij, investimet do të vazhdojnë të realizohen edhe në vitin 2023 në infrastrukturë rrugore, shkollore, kulturë rini e sport, zhvillim ekonomik si dhe do të ketë edhe rritje të subvencioneve në bujqësi.

Komentet:

Brahim Dalloshi :

Zgjerimi i rrugës që lidh lagjen Dallosh me atë të lagjes Topalli dhe zgjidhjen e problemit të ujit të pijes

Fadil Vishi

Rregullimi i shtratit të rekës që përshkon në fshatin Dubravë

Ismajl Baftiu:

Krijimi i një hapësire për hedhjen e mbeturinave inerte

Nuhi Mema:

Asfaltimi i rrugës lagjja e Re

Bujar Baftiu:

Zgjerim të rrugës “ 25 maji” si dhe zgjidhje të problemit të grumbullimit të ujit po në këtë rrugë

Selman Berisha:

Më shumë mbikëqyrje të punimeve në ujësjellës

Ibrahim Imishti:

Asfaltim dhe rregullim të rrugës “ Oso Kuka” si dhe rrugës “ Qendresa” si dhe rrugës private në pronësi të Nusret Imishtit, si dhe vendosje të shportave në hapësirat publike përkatësisht afër Shkollës Fillore “ kadri Zeka”.

Muharrem Baftiu:

Rregullim të rrjetit të rrymës, për arsye të vjetërsimit të shtyllave elektrike, si dhe asfaltim të rrugës të quajtur “ Shullani”

Tefik Vishi

Ndërtim i Sallës së edukatës Fizike në ShF “ kadri Zeka” Dubravë

Të pranishmit në debat morën përgjigje dhe bashkëbiseduan me ekzekutivin komunal, ndërsa përgjigjet zyrtare janë të paraqitura edhe në raportin e konsultimit publik me po të njetën temë.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selino



Shpenzime Komunale, 10,000.00 euro, kategori nga e cila paguhen shpenzimet për rrymë, ujë, mbeturina, shpenzimet telefonike, për objektet që menaxhohen nga DKRS;
Subvencione dhe Transfere, 70,000.00 euro, nuk ka ndryshim krahasuar me vitin aktual 2022, mirëpo ne si Drejtori kemi kërkuar vazhdimisht rritje të vlerës së Subvencioneve, ku automatikisht rritet edhe mbështetja ndaj OJQ-ve ;

Në kategorinë e Investimeve Kapitale, kemi të ndara 185,000.00 euro.
Si organizate buxhetore, Buxheti i Komunes se Kaçanikut, për vitin 2023 parshikohet të jetë 10,674,688.00 euro.

Në këtë takim u paraqitën edhe kërkesat nga pjesëmarrësit, ku edhe morën përgjigje nga drejtoresha dhe stafi, të cilat më pas u paraqitën edhe në raportin e dëgjimit publik.

Komentet:

Flakron Tusha:

Përgëzoj përkrahjen e nënkryetarit dhe drejtoreshës ndaj sportit. Kërkoj që koha e aplikimit për grante të jetë më e gjatë, për shkak të procedurave dhe kompletimit sa më të mirë të dokumentacioneve.

Të bëhet ndarje reale e mjeteve financiare për klubet dhe OJQ, psh Klubit “ Lepenci” i janë ndarë shumë mjete në krahasim me klubet tjera. Të gjitha OJQ-të që kërkojnë me marrë subvencione të tregohen kreative e jo vetëm me letra.

Arben Thaqi:

Shpresoj që shkollat e futbollit të jenë pjesë e subvencioneve komunale. Kërkoj rritje të buxhetit për OJQ-të për shkak të rritjes së kostos së shpenzimeve të jetesës. Të kategorizohen OJQ-të dhe të ndahen mjete më të mëdha për ato që kanë më shumë masivitet krahas atyre individuale si dhe suksesi i OJQ-ve dhe Klubeve Sportive të jetë prioritet për ndarjen e subvencioneve. Investimet kapitale e lehtësojnë punën tonë.

Poashtu dua të shpreh një shqetësim sepse janë shpërblyer disa OJQ që nuk kanë të bëjnë me sport por që kanë hyrë në kategorinë e subvencioneve të sportit, ndërsa kërkoj që të futet si kriter edhe mosha tek fëmijët për subvencione sportive sepse ata nuk punojnë.

Afrim Bunjaku: Klubi “ Bazelli”

Çdo klub synim ka suksesin e për të arritur suksese duhet të punohet në këtë drejtim. Klubi jonë është i vetmi klub që e ka përfaqësuar Kosovën me vajza në futboll. Kërkoj që kriter për subvencione të jetë edhe arritja e sukseseve. Sportet individuale kanë më pak shpenzime. Kërkoj ndarje të drejtë të subvencioneve dhe rritje të buxhetit.

Ardiana Tusha- Kryetare e KVRL-së

Mënyra e ndarjes së subvencioneve ka shkuar në mënyrë të drejtë dhe transparente, ,mirëpo kërkojmë ndarje paralele të subvencioneve. Klubet po favorizohen në mënyrë të pabarabartë.

Flakron Tusha- Up to Youth

Ndarja e subvencioneve është bërë gabim. Ndarja e subvencioneve të bëhet në bazë të suksesit dhe numrit të personave që do të jenë përfitues. Kërkoj që Klubit “ Lepenci” ti ulet shuma e ndarjes së subvencioneve komunale.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



1	Data 18.10.2022	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104/02-28137-3	



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Procesverbal nga Dëgjimi Publik me temë : Debat me të rinjtë, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të Shoqërive Kulturore Artistike, grupe jo formale artistike nga Komuna e Kaçanikut dhe Klubet Sportive

Data: 02.08.2022

Vendi: Palestra Sportive

Ora: 14:00

Takimin e hapi Drejtoresha për Kulturë, Rini e Sport Hafize Sallahu, e cila shpalosi planifikimet të drejtorisë.

Ajo tha se drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport ka bërë ndarjen e subvencioneve sipas rregullores dhe gjithashtu edhe në vitet në vijim do të punohet sipas kësaj rregullore. Për vitet në vijim si Drejtori kemi paraparë edhe blerjen e një Minibus i cili do të jetë në shërbim të të gjitha OJQ-ve dhe Klubeve sportive të cilat veprojnë në komunën tone, e cila është një ndihmesë e madhe për uljen e shpenzimeve për OJQ-të dhe klubet sportive. Gjithashtu është kërkuar nga të gjitha OJQ-të dhe Klubet Sportive përfituese të Subvencioneve tu përmbahen rregullores dhe afateve të raportimit dhe gjithashtu të hulumtohen edhe fonde tjera si dhe të shfrytëzojnë ligjin për sponzorizim .

Më pas zyrtari financiar i kësaj drejtorie Valdrin Dogani, paraqiti edhe në detaje planifikimet buxhetore

Buxheti i ndarë për DKRS, për vitin 2023, në total, vlerësohet të jetë 477,789.00 euro.

Ndarja sipas kategorive:

Paga dhe mëditje, 92,789.00 euro, si drejtori me një ekip me 16 punëtor aktual nga totali prej 18, numri i aprovuar i punëtorëve;

Mallra dhe Shërbime, 120,000.00 euro, ku kemi një vlerë 5 herë më të madhe në krahasim me vitin aktual, 2022, pasi ka qenë viti i parë ku veprojmë si Drejtori në vete, ndaras nga Drejtorja e Arsimit;



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



I	Data	18.10.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	Shitje	
01	104/02-28137/-4			



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Procesverbal nga Dëgjimi publik:

Debat me bizneset nga Komuna e Kaçanikut

Data: 08.08.2022

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora: 14:00

Ndonëse i paralajmëruar në kohë reale dhe i shpërndarë njoftimi një ditë para mbajtjes së dëgjimit publik, i pranishëm nuk ka qenë asnjë pjesëmarrës, andaj si dëgjim publik ka dështuar. Të pranishëm e të gatshëm për tu dhënë shpjegime përfaqësuesve të bizneseve ishte drejtoresha për Zhvillim Ekonomik dhe stafi, por që për shkak të mungesës së pjesëmarrësve një debat i tillë ka dështuar të mbahet.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	18.10.2022	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-28137/-5			



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Procesverbal nga Dëgjimi publik:

Debat me fermerë nga Komuna e Kaçanikut

Data: 02.08.2022

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora: 14:00

Ndonëse i paralajmëruar në kohë reale dhe i shpërndarë njoftimi një ditë para mbajtjes së dëgjimit publik, i pranishëm ka qenë vetëm një pjesëmarrës, andaj si dëgjim publik ka dështuar. Të pranishëm e të gatshëm për tu dhënë shpjegime fermerëve ishin drejtori për Bujqësi dhe stafi, por që për shkak të mungesës së pjesëmarrësve një debat i tillë ka dështuar të mbahet.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	18.10.2022	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	104/02-28137/-6		



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Procesverbal nga Dëgjimi i përgjithshëm publik: Lidhur me Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe planifikimet për vitet 2024-2025

Data: 17.08.2022

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora: 14:00

Komuna e Kaçanikut përmes ekzekutivit komunal, i cili ka hartuar Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe planifikimet për vitet 2024-2025, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, organizoi dëgjimin public me qytetarë të komunës me temë: Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe planifikimet për vitet 2024-2025.

Në takim prezantoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut Besim Ilazi me stafin e tij ekzekutiv.

Takimin e hapi Kryetari i Komunës së Kaçanikut Besim Ilazi, i cili tha se këto dëgjime publike ndihmojnë në shpërndarjen sa më të mirë dhe më të drejtë të buxhetit, ndërsa u shpreh i shqetësuar për mos interesimin e qytetarëve për të qenë pjesë e debateve publike, ndonëse sipas tij komuna ka ofruar mundësi dhe orare të ndryshme të dëgjimeve publike, për të cilat njoftimet publike janë publikuar me kohë.

Ndërkohë në lidhje me buxhetin për vitin 2023 foli drejtori për Buxhet dhe Financa Bahri Selimi, i cili tha se buxheti për vitin 2023 ka arritur shifrën 10 milionëshe, ndërsa vetëm për kategorinë investimet kapitale janë të planifikuara 2 milion e 971 mijë e 313 euro. Sipas tij, investimet do të vazhdojnë të realizohen edhe në vitin 2023 në infrastrukturë rrugore, shkollore, kulturë rini e sport, zhvillim ekonomik si dhe do të ketë edhe rritje të subvencioneve në bujqësi.

Ndërkohë, drejtori për Arsim Zahir Doda bëri të ditur nga ky debat publik, që të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në Shkollën e Mesme Profesionale "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka" do ta kenë të paguar udhëtimin nga Komuna e Kaçanikut.

Të pranishmit në debat, përfaqësues të fshatrave, OJQ-ve e qytetarë të tjerë, kërkuar edhe më tutje investime në infrastrukturë rrugore, ndriçim e trotuare, infrastrukturë shkollore, investime në rrjetin e ujësjellësit e kanalizimit, ruajtje të ambientit, ndërsa paraqitën edhe si shqetësim ndotjen e ujit në Lumin Nerodime e shumë kërkesa të tjera që ndërlidhen me mirëqenien qytetare.

Komentet:

Remzi Reka “ Organizata “ Gjehti”

Probleme me ujë të pijes

Rregullimi i kanalizimeve, presioni të bëhet për Komunën e Ferizajt që derdh kanalizimin në Lumin Nerodime si dhe presion të bëhet edhe tek institucionet qendrore.

Rregullimi i Objektivit të Shkollës Filllore “ Emin Duraku” si dhe rregullim të parkingut nëntokësor në këtë pjesë si dhe rregullim i hyrjes tek shkolla

Të bëhet presion mbi institucionet qendrore për përfundimin e projekteve të mbetura në gjysmë që kanë qenë të financuara nga qeveria dhe të financohen projekte të reja

Rruga për fshatin Kërbliq- Komuna e Vitisë e ka rregulluar pjesën e saj, ndërsa ka mbetur pa u rregulluar pjesa që i përket komunës sonë më shumë

Mbrojtje e pyjeve nga prerësit ilegal

Gjendje jo e kënaqshme me menaxhim të mbeturinave, mungesë e deponisë për mbetje të ngurta

- **Kryetari Besim Ilazi:** Ne projekt buxhetin e vitit 2023 janë planifikuar 150,000.00€ për ndërtimin e rrjeteve të ujësjellësit. Planifikohet zgjidhja e problemit me furnizim me ujë edhe për kuotat me të larta të zonës urbane

Rrjeti i kanalizimeve fekale është kryer mbi 90% e të gjithë territorit të komunës së Kaçanikut. Tashme janë hartuar projektet e detajuara edhe për dy kolektorë përgjatë lumit Nerodime dhe Lepenc.

- Është një projekt që kap shifrën mbi 1 milion euro, dhe si i tillë është i pamundur që të financohet nga buxheti komunal, ndërsa për çdo vit projektin e përcjellim në institucionet qendrore për financim, mirëpo deri më tani nuk kemi pasur përkrahje. Sa për të evituar pak gjendjen e rëndë, momentalisht është duke u punuar në rregullimin e nyjeve sanitare.
- Për çdo vit në shtator, përcjellim kërkesat tona në institucionet qendrore për të përkrahur projektet tona dhe për të futur në listën e investimeve nga niveli qendror. Edhe këtë vit do të bëhet presion që të paktën projektet e mbetura në gjysmë por edhe fillimi i projekteve të reja të jenë në listën e investimeve nga ministritë linje.
- Është nënshkru marrëveshja mes Kryetarit të Vitisë dhe Ministrisë, vite më parë, por projekti është mbetur në gjysmë dhe komuna e Kaçanikut nuk është njoftuar asnjëherë në lidhje me këtë projekt.
- Më shumë është duke u dëmtuar parku nacional që është nën mbikëqyrje të institucioneve qendrore, përkundër shkresave dhe insistimit tonë për të intervenuar, herë pas here ka intervenime për ta mbrojtur këtë pjesë, por jo aq sa duhet. Shpresojmë në reflektim më të madh nga niveli qendror.
-



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	18.10.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-28137/-7			



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Procesverbal nga Dëgjimi publik:

Debat me banorët e lokaliteteve Begracë, Kaçanik i Vjetër etj
07.08.2022
Vendi: Shkolla Fillore "7 shtatori" Begracë
Ora:18:00

Komuna e Kaçanikut përmes ekzekutivit komunal, i cili ka hartuar Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe planifikimet për vitet 2024-2025, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, organizoi dëgjimin public me qytetarë të komunës me temë: Propozim Buxhetin për vitin 2023 dhe planifikimet për vitet 2024-2025.

Në takim prezantoi Kryetari I Komunës së kaçanikut Besim Ilazi me stafin e tij ekzekutiv.

Takimin e hapi Kryetari i Komunës së Kaçanikut Besim Ilazi, i cili tha se këto dëgjime publike ndihmojnë në shpërndarjen sa më të mirë dhe më të drejtë të buxhetit, ndërsa u shpreh i shqetësuar për mos interesimin e qytetarëve për të qenë pjesë e debateve publike, ndonëse sipas tij komuna ka ofruar mundësi dhe orare të ndryshme të dëgjimeve publike, për të cilat njoftimet publike janë publikuar me kohë.

Ndërkohë në lidhje me buxhetin për vitin 2023 foli drejtori për Buxhet dhe Financa Bahri Selimi, i cili tha se buxheti për vitin 2023 ka arritur shifrën 10 milionëshe, ndërsa vetëm për kategorinë investimet kapitale janë të planifikuara 2 milion e 971 mijë e 313 euro. Sipas tij, investimet do të vazhdojnë të realizohen edhe në vitin 2023 në infrastrukturë rrugore, shkollore, kulturë rini e sport, zhvillim ekonomik si dhe do të ketë edhe rritje të subvencioneve në bujqësi.

Të pranishmit në debat parashtruan kërkesat e tyre.

Naser Gashi: falenderoj Kryetarin e Komunës për realizimin e shumë projekteve të deritanishme në fshati Begracë në theks të veçantë në ndërtimin e sallës së Edukatës fizike, ndërsa kërkoj që rruga kryesore e fshatit të bëhet rrugë regjionale.
Naim Luzha: Kërkojmë rregullimin e problemeve me ujë të pijes

Faton Luzha: Kërkoj rregullimin e problemeve të kanalizimit dhe krijimin e hapësirave gjelbëruese në afërsi të shkollës fillore dhe rregullimin e një fushe sportive të jashtme.

Të pranishmit në debat morën përgjigje dhe bashkëbiseduan me ekzekutivin komunal, ndërsa përgjigjet zyrtare janë të paraqitura edhe në raportin e konsultimit publik me po të njetën temë.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi



- Njësia operative e KRM "Pastertia" ne Kaçanik tashme është furnizuar me tre kamion te rinj për grumbullimin e mbeturinave dhe pritet te sjellim edhe një kamion tjetër i fituar nga Grandi i Performances komunale "Mjedisi i Pastër"

Ardiana Tusha- Kryetare e KVRL-së

Trajtimi i ujërave të zeza mbi Lumin Nerodime si dhe largimi i barishteve

A është paraparë vendosja e ndonjë laure gjatë ndërtimit të hekurudhës, në vendin afër Dushkajës?

Bashkëpunim më të madh me Policinë e Kosovës dhe Inspektorët për parandalimin e problemit të zhurmës nëpër lokale

Ramadush Osmani- Drejtor i Shërbimeve Publike

Përmes kontratës njëvjeçare "Mirëmbajtja e hapësirave te gjelbëruara" behet pastrimi i shtratit te lumit Nerodime çdo vit.

Besim Ilazi- kryetar i Komunës:

- Projekti i ndërtimit të hekurudhave është projekt nga niveli qendror, mirëpo ne jemi njoftuar dhe kemi marrë informata më të hollësishme në lidhje me projektin në fjalë, ku është paraparë edhe vendosja e një laure në vendin afër Dushkajës.
- Sipas rregullores komunale është paraparë që lokalet të punojnë deri në orën 24:00, kurse sa i përket zhurmës është një procedurë tjetër. Edhe po ta kemi në dispozicion aparatin e matjes së zhurmës, duhet të jetë një kompani e licencuar që do të duhej ta bënte një punë të tillë. Megjithatë, si institucione në bashkëpunim me Policinë e Kosovës jemi duke u munduar dhe trajtuar këtë problem, për të ardhur deri tek një zgjidhje.

Rrustem Zenuni- Asambleist

Projekti " ndërtimi i trotuarit në rrugën Ahmet Kaqiku" të zhvendoset nga viti 2024 në vitin 2023

Ndërtimi i trotuarit në Gabrricë

Disa biznese tek vendi i quajtur " te Lushi" nuk kanë qasje në kanalizim primar

Rregullimi i hapësirës publike në hyrje të fshatit Duraj- do të plotësonte nevojat edhe të fshatrave për rreth

Rregullim të disa rrugicave në këto anë

Ramadush Osmani- Drejtor i Shërbimeve Publike

- Projekti " Ndërtimi i trotuarit në rrugën Ahmet Kaqiku" është i koduar ne projekt buxhetin për vitin 2023 dhe fillimisht do te hartohet projekti i detajuar me mjetet e ndara ne këtë vit.

Të bëhet hapja e rrugës që lidh fshatin Semajë e qytetin e Ferizajt

- Përmes kontratave ekzistuese si “Mirëmbajtja e rrugëve lokale” dhe “ndërtim i rrugëve ne zonën urbane dhe rurale” do te shqyrtohet mundësia e hapjes dhe shtrimit te kësaj traseje te rrugës qe lidhe fshatin Semaje dhe Gaçke.
- Fillimisht do te analizohet hapësira e trasesë se rrugës nëse ekziston mundësia e ndërtimit te segmentit te trotuarit ne rrugën “Razim Hasaj”-Gabrricë
- Është hartuar projekti i detajuar për shtrirjen e kanalizimit fekal përgjatë rrugës magjistrale nga lagjja Dedaj deri ne fushe te Pajtimit, për këtë projekt do te shqyrtohet mundësia e realizimit përmes kontratës “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”
- Kjo ide do te analizohet dhe do te shqyrtohet mundësia e realizimit përmes projektit “Ndërtimi dhe rregullimi i parqeve publike”
- Rrugicat lokale do te asfaltohen ne vazhdimësi përmes kontratës “Ndërtimi i rrugëve ne zonën urbane dhe rurale”

Qendrim Vogliqi_ Administrator i Gërlicës së Epërme:

Futja e një kodi buxhetor për konkurse arkitektonike

A parashihet asfaltimi i rrugëve të pa emëruara që lidh 3 deri në 4 shtëpi?

Punime më cilësore në terren nga kompanitë e kontraktuara dhe të dënohen kompanitë që nuk i kryejnë punët sipas kontratës

Të ketë më shumë sqarime në emërtim të projekteve te lista kapitale psh: Rregullimi i fushave sportive, për cilat fusha bëhet fjalë, më shumë sqarime tek projekti i Gurit të Shpum etj.

Ramadush Osmani- drejtor i Shërbimeve Publike

- Komuna ka aktive kontratën ”Hartimi i projekteve”, kurse për projekte me specifike parasheh edhe konkurse projektimi siç kemi praktikuar te projekti “Ndërtimi i sheshit te qytetit”
- Çdo projekt qe realizohet ne teren i nënshtrohet pranimit teknik nga komisioni profesional dhe me pas është periudha 1 vjeçare garantuese qe kompania është e obliguar te sanoj defektet qe paraqiten gjatë kësaj periudhe.
- Rrugicat qe janë prone komunale apo janë ne proces te shpronësimit pas pranimit te deklarave nga pronaret qe heqin dore nga pronësia për ndërtim te rrugicave, sipas arsyeshmerisë se tyre do te asfaltohen përmes kontratës Ndërtimi i rrugëve ne zonën urbane dhe rurale”

Flakron Tusha:

Më shumë investime në Shkollën e Mesme Profesionale

Të shikohet mundësia e gjetjes së një forme juridike për të parandaluar zhurmën e madhe nga kafiteritë, sidomos gjatë orëve të natës

Zahir Doda- Drejtor i Arsimit

- Në Shkollën e mesme Profesionale, në vazhdimësi janë realizuar investime, ku në përfundim e sipër tashmë është edhe salla e edukatës fizike. Komuna e Kaçanikut këtë institucion arsimor poashtu në vazhdimësi e furnizon me materiale të nevojshme për realizim të punës praktike, varësisht nga drejtimet. Poashtu që nga ky vit të gjithë nxënësit nga kjo shkollë do ta kenë të paguar udhëtimin nga Komuna e Kaçanikut.

Besim Ilazi- Kryetar i Komunës

- Sipas rregullores komunale është paraparë që lokalet të punojnë deri në orën 24:00, kurse sa i përket zhurmës është një procedurë tjetër. Edhe po ta kemi në dispozicion aparatin e matjes së zhurmës, duhet të jetë një kompani e licencuar që do të duhej ta bënte një punë të tillë. Megjithatë, si institucione në bashkëpunim me Policinë e Kosovës jemi duke u munduar dhe trajtuar këtë problem, për të ardhur deri tek një zgjidhje.

Hasip Salihu- Administrator i fshatit Bajnicë:

Shqetësim mungesa e ujit të pijes

•

Pengesa e vendosur në rrugën “ Hetem Hasaj” e vrazhdë dhe si e tillë kërkojmë të largohet

Ramadush Osmani:

- Ne vitin 2023 përmes projektit “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit do të shqyrtohet mundësia për rritjen e kapacitetit për ujë të pijes në fshatin Bajnice.
- Përmes kontratës ekzistuese si “Mirëmbajtja verore e rrugëve lokale” do të largohen pengesat (barrierat) në rrugën “Hetem Hasaj”-Gabrrice-Bajnice

Kemajl Jaha- Administrator i fshatit Stagovë:

Të shtrohet me trotuar pjesa prej varrezave të dëshmorëve deri tek Stadiumi si dhe prej qytetit të Kaçanikut që lidhet me fshatin Stagovë

Të paguhet udhëtimi i nxënësve të cilët vijojnë mësimin në shkollën fillore me mbi 3 kilometra largësi

Rregullimi i rrethojës së shkollës

Ramadush Osmani- Drejtor i Shërbimeve Publike

- Ne planifikimet e viteve te ardhshme do te parashihet ndërtimi i trotuarit përgjatë rrugës “Adem Jashari” segmenti nga varrezat e dëshmoreve deri ne fshatin Stagove

Jashar Selimi- Administrator i fshatit Kaçanik i Vjetër

Të vazhdohet me rregullimin e projekteve të lëna në gjysmë në këtë fshat, siç është banimi social dhe rregullimi i disa rrugicave.

Ramadush Osmani- Drejtor i Shërbimeve Publike

- Projekti i objekti për banim social është ne përfundim dhe rregullim i rrugicave do te realizohet sipas arsyeshmerisë se tyre do te asfaltohen përmes kontratës “Ndërtimi i rrugëve ne zonën urbane dhe rurale”

Të pranishmit në debat morën përgjigje dhe bashkëbiseduan me ekzekutivin komunal, ndërsa përgjigjet zyrtare janë të paraqitura edhe në raportin e konsultimit publik me po të njetën temë.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi

